

REFORMA E SISTEMIT TË DREJTËSISË NË KOSOVË

Adem Gashi • Betim Musliu



KOSOVO LAW INSTITUTE
INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

**FRIEDRICH
EBERT**

STIFTUNG

Prishtina Office



REFORMA E SISTEMIT TË DREJTËSISË NË KOSOVË

Adem Gashi • Betim Musliu



KOSOVO LAW INSTITUTE
INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

**FRIEDRICH
EBERT**
STIFTUNG

Prishtina Office

Ky raport është përkrahur nga: Friedrich Ebert Stiftung



Shënim: Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk shprehin domosdoshmërisht ato të Friedrich Ebert Stiftung.

Autorët: Adem Gashi dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Dhjetor 2013

Prishtinë, Republika e Kosovës

PËRMBAJTJA:

I.	Përmbledhje ekzekutive.....	4
ii.	Procesi i politikëbërjes rreth reformës të sistemit të drejtësisë	5
a.	Zanafilla e reformës dhe nevojat.....	5
b.	Grupet e interesit të përfshira në bërje të politikave dhe ligjeve për reformën.....	6
c.	Politikëbërja për reformë	11
iii.	Reforma legjislativë	14
iv.	Reforma kadrovike në sistemin e drejtësisë.....	16
v.	Reforma strukturore dhe përkrahja me resurse.....	18
vi.	Çështje tjera	20
a.	Cënimi i pavarësisë së gjyqësorit.....	20
b.	Llogaridhënia gjatë procesit të ri-emërimit dhe emërimit	21
c.	Avokacia në Kosovë.....	22
d.	Shërbimi korrektues dhe sprovues	23
vii.	Indikatorët	24
a.	Indikatorët për sistemin gjyqësor.....	24
b.	Indikatorët për sistemin prokurorial.....	31
viii.	Rekomandime	36

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Sistemi i drejtësisë, sikurse edhe të gjitha sferat tjera institucionale në Kosovë, kishte pësuar rëndë gjatë apartheidit të viteve '90, si dhe luftës në vitet 1998-99, pasi që ishte marrë nën kontroll absolut nga regjimi Millosheviqian. Apartheidi dhe sistemi komunist kanë lënë pasojë të rënda, me theks të veçantë sa i përket kuadrove të drejtësisë, të cilat rëndojnë edhe në ditët e sotme këtë sistem. Menjëherë pas përfundimit të luftës, UNMIK kishte krijuar gjyqësorin emergjent të përbërë nga prokurorë dhe gjykatës vendor, duke trashëguar strukturë të gjykatave dhe prokurorive, metodë të punës, ligje, dhe mentalitet të së kaluarës, përkatësisht të sistemit komunist. Diskutimi më i hershëm për reformë ndërlidhet me strukturën e gjyqësorit dhe sistemit prokurorial në Kosovë, duke parë se struktura e trashëguar nuk ishte funksionale. Statusi i pazgjidhur i Kosovës ishte pjesërisht shkaktar për vonesën e reformave të thella në sistemin e drejtësisë.

Pas pavarësisë së Kosovës, iniciativat për reforma më substanciale dhe multi-dimensionale janë intensifikuar, të cilat janë ndërlidhur ngushtë me procesin e shtet-ndërtimit ku Pako e Ahtisarit ka qenë bosht dhe është mishëruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në këtë frymë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës kishte garantuar pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe prokurorial, duke krijuar një qeverisje me kontroll dhe balanc ndryshe prej të kaluarës. Për më tepër, përmes Kushtetutës dhe ligjeve përcjellëse gjykatësve dhe prokurorëve iu është garantuar mandati deri në pensionim dhe paga dinjitoze, duke shënuar një progres të theksuar drejt një gjyqësori të pavarur. Megjithatë, pavarësia e gjyqësorit edhe është cenuar, sidomos në pjesën e buxhetimit, ku pikërisht reforma është përkrahur minimalisht sa i përket resurseve. Reforma ligjore kishte përfshirë edhe aspekte tjera, sikurse krijimi i mekanizmave jashtë-gjyqësor duke ndihmuar kështu efikasitetin e gjyqësorit. Në frymën e një reforme të thellë, është hartuar edhe Kodi i ri Penal dhe Kodi i ri i Procedurës Penale. Aspekti procedural i reformës legislative mund të kritikohet në masë të madhe, për shkak të mungesës së konsultimeve me publikun rreth ndryshimeve.

Gjatë këtyre iniciativave, gjyqësori ka synuar të reformojë edhe kuadrot. Sfidë më e madhe në procesin e ri-emërimit dhe emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve ka qenë thithja e kuadrove profesionale në sistem. Mungesa e ofertës së qartë dhe në përgjithësi kuadrot jo-profesionale kanë ndikuar negativisht në rezultatet e këtij procesi.

Në përgjithësi, kësaj reforme i ka munguar një strategji gjithëpërfshirëse që do të orientonte angazhimin e institucioneve të ndryshme dhe do të bënte më të matshëm vlerësimin e arritjeve të reformës. Mungesa e një strategjie gjithëpërfshirëse ka bërë që institucionet të krijojnë institute dhe mekanizma të ri, të ri-dizajnojnë procedura dhe mekanizma ekzistues, dhe të ndërmarrin aktivitete tjera në baza ad-hoc dhe duke reaguar sipas nevojës.

Në mungesë të indikatorëve të qartë në bazë të të cilëve do të duhej të matej progresi i shënuar me reformë, IKD ka zhvilluar disa indikatorë të cilët do të shërbenin për të bërë matjet në baza periodike.

II. PROCESI I POLITIKËBËRJES RRETH REFORMËS TË SISTEMIT TË DREJTËSISË

a. Zanafilla e reformës dhe nevojat

Sistemi i drejtësisë, sikurse edhe të gjitha sferat tjera institucionale në Kosovë, kishte pësuar rëndë gjatë apartheidit të viteve '90, si dhe luftës në vitet 1998-99, pasi që ishte marrë nën kontroll absolut nga regjimi Millosheviqian. Përgjatë një dekade prokurorë dhe gjykatës shqiptarë ishin dëbuar dhe ishin lënë jashtë institucioneve të drejtësisë, duke iu mundësuar vetëm ushtrimi i funksionit të mbrojtësve ligjor në një sistem plotësisht të varur dhe të ndikuar politikisht. Apartheidi dhe sistemi komunist kanë lënë pasojë të rënda, me theks të veçantë sa i përket kadrove profesionale të drejtësisë, të cilat rëndojnë edhe në ditët e sotme këtë sistem. Rrjedhimisht, Kosova ka pasur nevojë urgjente të inicioj reformat kadrovike, strukturore/organizative, si dhe ligjore ashtu që të adresojë sfidat e një shoqërie post-komuniste dhe një vendi të dalë nga apartheidi dhe lufta.

Menjëherë pas përfundimit të luftës, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) kishte bërë rishikim të sistemeve, atij gjyqësor dhe prokurorial. Megjithatë, ky rishikim kishte të bënte më shumë me një gjendje emergjente dhe kishte adresuar sfidat afatshkurta. UNMIK kishte krijuar gjyqësorin emergjent të përbërë nga prokurorë dhe gjykatës vendor, duke trashëguar strukturë të gjykatave, metodë të punës, ligje, dhe mentalitet të së kaluarës, përkatësisht të sistemit komunist.¹ Statusi i pazgjithur i Kosovës kishte lënë peng edhe reformat² e thella mase të nevojshme në sistemin e drejtësisë, duke lënë këtë sistem të varur dhe nën pushtetin suprem të Përfaqësuesit Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP).

Në ndërkohë, Kosova është përballur me shumë sfida,³ të cilat “kanë vënë gjyqësorin në një gjendje thujse konstante të reformimit.”⁴ Në vazhdimësi, UNMIK si dhe Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ) janë angazhuar që të nxjerrin politika, ligje dhe të themelonin mekanizma e institucione të cilat do të ndikonin pozitivisht në sistem, ku arritje e madhe ishte hartimi dhe hyrja në fuqi e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale në vitin 2004. Ndërsa deri në vitin 2008, kanë ndodhur reforma të cilat më shumë janë ndërlidhur me bartje të kompetencave nga ndërkombëtarët tek vendorët.⁵ Pas pavarësisë, iniciativat për reforma më substanciale dhe multi-dimensionale janë intensifikuar, të cilat janë ndërlidhur ngushtë me

¹ Haxhaj R., *Çështjet e reformës në sistemin gjyqësor të Kosovës* (Prishtinë: Konferenca Vjetore, 2008).

² *Po aty*.

³ Sipas OSBE-së sfidat përfshijnë “[gjyqësori në Kosovë] ballafaqohet me një mori sfidash komplekse dhe serioze duke përfshirë ngarkesë të madhe të lëndëve, krim të organizuar të rrënjosur, konteste pronësore të ndërlikuara, trashëgimi të një ndikimi të fuqishëm të ekzekutivit, krime ndëretnike, pretendime për korrupsion, një ngarkesë të mundimshme e me raste të krimeve të luftës, dhe infrastrukturë të dobët, sa për t’i numëruar ato më të theksuarat.” *Pavarësia e gjyqësorit në Kosovë: Dimensionet Institucionale dhe Funksionale* (Prishtinë: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë, janar 2012), f. 6.

⁴ *Pavarësia e gjyqësorit në Kosovë: Dimensionet Institucionale dhe Funksionale* (Prishtinë: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë, janar 2012), f. 6.

⁵ Këtu duhet të merren parasysh themelimi i Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe themelimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (i cili ishte themeluar në vitin 2005 në vend të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës që kishte funksionuar nga prill 2001).

procesin e shtet-ndërtimit ku Pako e Ahtisarit ka qenë bosht dhe është mishëruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kushtetuta i ka hapur rrugën krijimit të legjislacionit, rregullimin e arkitekturës dhe qeverisjes të pavarur të sistemit të drejtësisë, ku në bazë të OSBE-së, reformat legjislative dhe gjyqësore përfshijnë një numër të madh të ligjeve.⁶ Të gjitha këto ndryshime ligjore kanë rezultuar me ndryshime rrënjësore në sistem.

b. Grupet e interesit të përfshira në bërje të politikave dhe ligjeve për reformën

Komuniteti ndërkombëtarë, fillimisht UNMIK që kishte administruar Kosovën dhe pastaj ICO që kishte mbikëqyrur pavarësinë, ka qenë bartësi kryesor dhe me ndikimin më të madh në procesin e bërjes së politikave dhe ligjeve në Kosovën e pas luftës.

Administrata e UNMIK-ut kishte për qëllim themelimin e institucioneve bazike për funksionim të qeverisjes së vendit. Në aspektin institucional, në fillet e saj të para, janë themeluar disa institucione bazike me kompetenca shumë të kufizuara pa funksionimin e të cilave ka qenë e pamundur zhvillimi i çdo sferë të jetës në Kosovë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës (KGJPK) është shndërrua në Këshill Gjyqësor të Kosovës. Gradualisht, me ngritjen e kapaciteteve vendore ka filluar dhe janë transferuar kompetencat nga ndërkombëtarët tek vendorët. Gjatë kësaj kohe nuk është punuar në reforma të thella dhe nuk janë zhvilluar dhe ndërtuar politika afatgjate për një sistem të drejtësisë funksional, kjo ndër të tjera për shkak të paqartësisë rreth statusit të pazgjidhur të Kosovës. Vëmendje më e madhe i është kushtuar tranzicionit dhe kalimit të kompetencave graduale tek institucionet vendore duke pasur kujdes që kompetencat e caktuara me elemente shtet-formuese të mbesin në duar të institucioneve ndërkombëtare. Rrjedhimisht, pa zgjidhjen e statusit politik dhe juridik të Kosovës, ka qenë e pamundur të formësohet sistemi i drejtësisë përmes reformave substanciale. Madje edhe pas shpalljes së pavarësisë kompetenca me elemente shtet-formuese vazhdojnë të mbesin në duar të institucioneve ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe UNMIK-un, sikurse që është rasti me bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë në çështje penale, Interpoli, e të tjera.

Përkundër hapësirës për të vepruar, UNMIK, që kishte prioritet stabilitetin e vendit, nuk kishte ndërmarrë veprime dhe reforma sa i përket aspektit kadrovik, dhe mos plotësimin e pozitave të lira për gjykatës dhe prokurorë, që do të ndikojë në vitet e pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës e deri më sot në funksionalizimin dhe efikasitetin gjyqësor dhe prokurorial.

Propozimi Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës kishte definuar statusin e Kosovës, kishte përcaktuar edhe konstruktin e shtetit, dhe rrjedhimisht kishte definuar pozitën e pushtetit

⁶ Ligji për Gjykatat; Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, 30 shtator 2010; Ligji nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, 30 shtator 2010; Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Ligji nr. 03/L-202 për konfliktet administrative, 16 shtator 2010; Ligji nr. 03/L-191 për ekzekutimin e sanksioneve penale, 22 korrik 2010; Kodi. 03/L-193 i drejtësisë për të mitur, 8 korrik 2010; Ligji nr. 03/L-117 për Avokatinë, 12 shkurt 2009; Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese, 16 dhjetor 2008; Ligji nr. 03/L-123 për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, 16 dhjetor 2008 (për të ndihmuar rreth procesit të riemërimit/trishikimit); Ligji nr. 03/ L-007 për Procedurën Jokontestimore, 20 nëntor 2008; Ligji nr. 03/L-002 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Kosovës, 6 nëntor 2008; Ligji nr.. 03/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale, 6 nëntor 2008; Ligji nr. 03/L-10 për Noterinë, 17 tetor 2008; Ligji nr.. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (Kodi i Procedurës Civile), 30 qershor 2008; Ligji nr. 03/L-008 mbi Procedurën Ekzekutive, 2 qershor 2008; Ligji nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale, 13 mars 2008; dhe Ligji për kompetencat i cituar më sipër. *Pavarësia e gjyqësorit në Kosovë: Dimensionet Institucionale dhe Funksionale* (Prishtinë: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë, janar 2012), f. 7.

gjyqësor. ICO u angazhua në vendosjen e themeleve të shtetit demokratik dhe ligjeve që do të siguronin zbatimin e Pakos së Ahtisaarit që ishte edhe udhërrëfyes për kornizën institucionale dhe ligjore të shtetit të pavarur. Reformat më të thella të sistemit konsiderohen të jenë ato pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në vitin 2008. Në këtë proces, akterët e ndryshëm kanë pasur konsensus për shumë iniciativa që të ndërmerren. Megjithatë, ndasitë më të mëdha kanë ekzistuar sa i përket krijimit të strukturave të veçanta në baza etnike. Komuniteti ndërkombëtarë kishte insistuar në themelimin e një Gjykate të Apelit në veri të Mitrovicës, për shkak të komunitetit serb në atë pjesë. Një gjë e tillë u kundërshtua nga Qeveria dhe përfundimisht nuk është përfshirë në ligjet bazike, duke përfunduar vetëm me një Gjykatë të Apelit në Prishtinë. Zgjidhja e këtij mospajtimi hapi rrugë për miratimin e ligjeve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe procedimin tutje me reformat në fusha të ndryshme të sistemit të drejtësisë.

Institucionet vendore qeverisëse, me theks të veçantë klasa politike, kanë pasur vullnetin minimal për të kontribuar në reformim të sistemit të drejtësisë. Përjashtojmë problemet me ri-strukturim dhe organizim të gjyqësorit dhe prokurorive për shkak të statusit të pazgjidhur të Kosovës, këto institucione duke anatemuar sistemin e drejtësisë vetëm sa kanë kontribuar në brishtësinë e tij. Institucionet kanë dështuar të krijojnë politika për zhvillim të kuadrove profesionale. Edukimi i juristëve ka pasur mangësi të theksuara,⁷ duke bërë kështu që të mos ketë numër të konsiderueshëm të profesionistëve të përgatitur për të kandiduar në procesin e ri-emërimit dhe emërimit në vitin 2009.

Sistemi gjyqësor dhe prokurorial kishte deleguar gjykatës dhe prokurorë për të kontribuar në përpilim të politikave dhe ligjeve. Për shkak të brishtësisë së sistemit, “nuk ka pasur kontribut të gjyqësorit por kontribut të gjykatësve në baza individuale sa i përket hartimit të ligjeve për gjykata dhe KGJK.”⁸ Përfundimisht, reformat legjislativë mund të pasqyrojnë mendimet personale të gjykatësve dhe prokurorëve të caktuar por jo politika të sistemeve si të tilla. Një problem i tillë vazhdon edhe në ditët e sotme kur është duke ndodhur procesi i ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve bazike të drejtësisë dhe themelimit të instituteve të reja të së drejtës.

Përgjatë gjithë procesit të reformave të ndryshme në sistemin e drejtësisë, organizatat e shoqërisë civile kanë qenë të mënjanuara. Një praktikë e tillë vazhdon edhe në ditët e sotme.⁹ Margjinalizimi i rolit të shoqërisë civile gjatë formësimit të politikave për reformën e sistemit të drejtësisë rezulton edhe me pasivizim të angazhimit të shoqërisë civile gjatë zbatimit të reformave për shkak të mangësive të njohurive rreth politikave dhe ligjeve, të cilat do të zbatohen. Mungesa e transparencës dhe bashkëpunimit me qytetarët është qasje tejet e dëmshme e reformimit të një sistemi kaq vital për shoqërinë. Pa ndërtim të konsensusit, shoqërisë po i imponohet t’i përshtatet normave të krijuara nga grupe të ngushta të interesit.

Donatorët e huaj patjetër se janë akterë kyç të të gjitha iniciativave të reformave në sistem të drejtësisë. Në përgjithësi, kontributi i tyre ka qenë pozitiv.¹⁰ Kjo për shkakun se institucionet vendore kanë pasur mungesë të resurseve për të ndërtuar politika për reformë të mirëfilltë. Edhe

⁷ Mangësitë kanë qenë në universitetin publik dhe institucionet e arsimit të lartë privat, të cilat nuk kanë pasur kushte dhe program për ofrim të arsimit ligjor të kualitetit të lartë, duke bërë kështu që juristët e diplomuar të kenë mangësi të shumta sa i përket të shkruarit ligjor, interpretimit të shkathët, apo ushtrim të përgjithshëm të funksionit të zbatuesit të ligjit. Këtu hyn edhe paaftësia e institucioneve për të organizuar trajnime kualitative dhe aktivitete tjera sikurse praktika në gjykata për të përgatitur juristët e ri. *Supra note 1*, f.7. Muharremi R., *Kosova dhe Integrimi i saj në Bashkimin Evropian* (Prishtinë: AUK, 13 prill 2008), f. 10.

⁸ IKD intervistë me Z. Albert Avdiu, Drejtor i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

⁹ Procesi i ligjërjes ka qenë jo-transparent dhe kanë munguar diskutime, lidhur me Kodin e ri Penal (2012), Kodin e ri të Procedurës Penale (2012), ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve bazike për gjyqësorin (2013-), dhe ndryshim të ligjeve tjera.

¹⁰ IKD intervistë me z. Hajredin Kuci, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Drejtësisë.

kjo përkrahje ka pasur anën tjetër të medaljes. Secili donatorë krahas përkrahjes është munduar të shtyjë përpara shkollën e vetë juridike.¹¹ Rrjedhimisht, legjislacioni për sistemin e drejtësisë nuk ka një frymë të një shkolle juridike nga fillimi deri në fund, por në të janë të gërshtuara disa sosh, duke ndërtuar një legjislacion të përzier. Kjo vije edhe si rezultat i paaftësisë së institucioneve vendore për të koordinuar ndihmën dhe kontributin e donatorëve të huaj. Përfundimisht, duhet të vendoset një vizion dhe të merren vetëm praktikatat të cilat i përshtaten kontekstit.

EULEX rezervon një vend të veçantë në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Pas shpalljes së pavarësisë, prania e këtij misioni ka pasur mjaftë rëndësi në përcaktimin e infrastrukturës së gjyqësorit dhe sistemit prokurorial në Kosovë, duke rezervuar kompetenca ekskluzive për ndjekje dhe gjykim të rasteve të caktuara. Qeveria e Kosovës gjithnjë ka kujdes të veçantë sa i përket rregullimit të kompetencave të këtij misioni, dhe gjithnjë i kërkohet që të konsultohet ngushtë me Bashkimin Evropian për ndryshimet e mundshme. Madje, në Kodin e ri Penal të Kosovës janë saktësuar kompetencat e Prokurorisë Speciale të Kosovës, e cila udhëhiqet dhe mbahet llogaridhënëse nga EULEX, duke futur çështje procedurale përkundër se nuk e kanë vendin aty.

Pavarësisht iniciativave të shumta, zhvillimi i ndryshimeve të mëdha është pranuar lehtë nga pjesa dërrmuese e institucioneve, politikëbërësve dhe qytetarëve. Ky është rezultat i ndërlidhjes të praktikës së sistemit ekzistues me sistemin komunist dhe regjimin aparteid.¹² Andaj, ndryshimet janë përqafuar shumë lehtë dhe pa ndonjë rezistencë.

¹¹ *Po aty.*

¹² *Po aty.*

	Mandati	Pozicioni	Konteksti	Përparimet	Ngecjet
UNMIK	<p>Administrimi i Kosovës gjatë periudhës emergjente deri në definimin e statusit</p> <p>Autoriteti Suprem i PSSP-së</p>	<p>Intervenimi në situata emergjente</p> <p>Ruajtja e stabilitetit politik</p> <p>Koncentrim i kompetencave në shtyllën e parë të UNMIK-ut respektivisht në gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtarë në Divizionin Penal të Departamentit të Drejtësisë (që ka luajtur rolin e Ministrisë së Drejtësisë)</p>	<p>Kur ka zbankuar e ka pasur situatën ku kemi qenë vend i pasluftës dhe pas komunizmit</p> <p>Statusi final i Kosovës i pazgjidhur</p> <p>Nivele të ndryshme të legjislacionit të aplikueshëm</p>	<p>Nxjerrja e: Kornizës Kushtetuese, Kodit të Përkohshëm Penal, Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale;</p> <p>Themelimi i institucioneve: KGJPK, KGJK, MD, MPB</p> <p>Infrastruktura për procesin e ri-emërimit dhe emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve, transferimi i kompetencave</p>	<p>Zvarritje e vazhdueshme e reformave deri në një kolaps të sistemit të drejtësisë</p> <p>Instalimi i një praktike të ndërhyrjeve në ndarje të drejtësisë përmes shfrytëzimit të kompetencave ekzekutive nga PSSP dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut, respektivisht Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.</p>
NEGOCIATAT KOSOVË-SERBI / MARTI AHTISAARI	<p>Definimi i statusit final të Kosovës</p> <p>Përafrim i qëndrimeve të palëve të dialogut Kosovë-Serbi.</p>	<p>Krijimi i institucioneve të pavarura të cilat do respektojnë standardet më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut</p>	<p>Kosova nën administrim ndërkombëtarë.</p>	<p>Pakoja e cila ka shtyrë përpara krijimin e Republikës së Kosovës, si një vend demokratik i cili bazohet në parimin e ndarjes së pushteteve</p>	<p>Ndikimi negativ i Serbisë në çështje të brendshme të Kosovës (paralizimi i shtrirjes së autoritetit në veri të Mitrovicës)</p>
VENDET E QUINTIT	<p>Ndikimi të cilin e ushtrojnë si partner të ndërtimit të shtetit të Republikës së Kosovës.</p>	<p>Krijimi i Gjykatës së Apelit në Mitrovicë</p> <p>Konflikt në mes të shkollave të ndryshme juridike (vendet më me ndikim ShBA, Gjermani, Britani e Madhe)</p>	<p>Qeveria e Kosovës të ndikueshëm nga komuniteti ndërkombëtarë</p>	<p>Kanë mbështetur dhe kanë ndërmarrë iniciativa</p>	<p>N/a</p>
INSTITUCIONET VENDORE EKZEKUTIVE DHE	<p>Mandati fillimisht mjaftë i kufizuar për shkak të UNMIK, pas</p>	<p>Kundërshtimi i krijimit të Gjykatës së Apelit në Mitrovicë</p>	<p>Të ndikueshëm prej ndërkombëtarëve, në proceset e</p>	<p>Angazhim në një numër të madh të iniciativave në</p>	<p>Mungesë e strategjisë gjithëpërfshirëse</p>

LEGJISLATIV E	pavarësisë primatin në hartim dhe vendosje në fuqi të ligjeve		ligjbërjes dhe zbatimit	koordinim me komunitetin ndërkombëtarë Themelimi dhe funksionalizimi i instituteve jashtë-gjyqësore	Zvarritje e hartimit dhe futjes në fuqi të ligjeve
INSTITUCION ET VENDORE GJYQËSORE (PËR MË TEPËR SHIH TABELAT E DETAJUARA MË POSHTË)		Hezitim për proces të ri-emërimit		Përfundim i procesit të tranzicionit nga struktura e vjetër në strukturën e re me kuadro të ri-emëruara dhe emëruara	Mungesë e llogaridhënies Mungesë e efikasitetit (rritje e rasteve të prapambetura) Mos plotësim i pozitave të lira të gjykatësve dhe prokurorëve Qëndrime individuale të gjykatësve dhe prokurorëve në konsultime për bërje të ligjeve
DIALOGU PRISHTINË-BEOGRAD / MARRËVESH JA PRILL 2013	Negociata teknike sipas rezolutës të dorëzuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara	Kosova: Sistem të unifikuar në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës Serbia: Krijimi i mekanizmave autonom të ndarë në baza etnike, territoriale, rrjetëzim paralel me rrjetin aktual	Vështirësi të shtrirjes së autoritetit të organeve të drejtësisë në veri të Kosovës	N/a	Paqartësi të thella rreth interpretimit/zbatimit të marrëveshjes

c. Politikëbërja për reformë

Menjëherë pas luftës, ishin ndërmarrë disa aktivitete hulumtuese dhe analiza për të adresuar reformën e gjyqësorit në kuadër të reformave të përgjithshme për rregullimin shtetëror të Kosovës. Në vazhdimësi vëmendje e shtuar i është kushtuar ristrukturimit të gjykatave dhe prokurorive ashtu që të qartësohen kompetencat, specializohen kuadrot, të thjeshtësohet sistemi dhe të ketë qasje më të lehtë për qytetarët. Në këtë frymë, krijimi i Gjykatave Themelore, të Apelit, dhe Gjykatës Supreme kishte qenë ideja më e pranueshme nga të gjitha palët që nga fillet e diskutimeve.

Këtu përfshihet kontributi i ekspertëve vendor, ndërkombëtarë dhe atyre të Institutit Max-Planck dhe Universitetit të Graz-it, të cilët kishin prezantuar nevojën për nxjerrje të ligjit për organizimin e gjykatave, duke rekomanduar strukturim të gjykatave në atë mënyrë që të ketë Gjykata Themelore me Degë të specializuara që do të vendosnin në shkallë të parë, Gjykata të Apelit që do vendosnin në shkallë të dytë, si dhe në shkallë të parë për vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, si dhe Gjykata Supreme, për të vendosur sa i përket mjeteve të jashtëzakonshme juridike dhe në raste të caktuara në shkallë të dytë.¹³

Sugjerimi i bërë në vitin 2002 për strukturën e Gjykatave në Kosovë:¹⁴




Figura 1 - Struktura e propozuar për gjykata në vitin 2002

Reforma e tanishme ka tipare të çështjeve të ngritura si dhe rekomandimeve të nxjerra në vitin 2002 në artikullin “Sugjerime për riorganizimin e gjyqësorit në Kosovë”,¹⁵ të autorit Rexhep

¹³ Haxhimusa, R., *Sugjerime për riorganizimin e gjyqësorit në Kosovës, Studime Juridike në Kosovë, Vol. 3, 2002/II* (Prishtinë: Qendra Juridike e Kosovës, 2002).

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Po aty.

Haxhimusa, në atë kohë Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës, qoftë sa i përket pavarësisë së gjyqësorit, organizimit struktural të tij, si dhe krijimit të instituteve jashtë-gjyqësore.

Reforma e tanishme gjyqësore ndërlidhet ngushtë edhe me vlerësimet dhe opsionet e ofruara nga një Grup i Vlerësimit Gjyqësor¹⁶ bazuar në kërkesën e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), e bërë më 14 maj 2002 dhe të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës.¹⁷ Si rezultat i kësaj pune ishte nxjerrë dokumenti me analiza të thukta të kontekstit të Kosovës si dhe rekomandimet konkrete për sistemin e drejtësisë në vend, të cilat u përmbledhën në raportin “Sistemi Gjyqësor i Kosovës: Vlerësim dhe Opsione të Propozuara, 2003-2004”. Çështja e strukturës më efikase të juridiksionit të sistemit të gjykatave ka qenë një nga çështjet bosht, të cilat kanë shpjerë tek rekomandimet e caktuara të këtij raporti. Ky vlerësim ka nxjerrë si përfundim se “sistemi i gjyqësorit të Kosovës është panevojshëmrisht i komplikuar nga (i) shumë tepër nivele gjykatash, dhe (ii) përgjegjësi që mbulojnë njëra tjetrën që ju caktohen gjyqtarëve, veçanërisht duke marrë parasysh madhësinë e popullsisë së Kosovës dhe pamjaftueshmërinë e burimeve financiare.”¹⁸ Raporti i njëjtë kishte sugjeruar ristrukturim të gjyqësorit dhe kompetencave të tyre, ku gjykatat komunale do të merreshin me lëndë të shkallës së parë, ato të qarkut do të merreshin me çështje të apelit, dhe kështu Gjykata Supreme do të shqyrtonte çështje të rëndësishme ligjore. Ky raport gjithashtu ka paraqitur edhe nevojën për krijim të mekanizmave jashtë-gjyqësor, gjykatat e specializuara, angazhimin e gjykatësve porotë si dhe angazhimin e personelit mbështetës.

Duke pasur parasysh këto si dhe hulumtime tjera sikurse ato të ABA ROLI-t,¹⁹ mund të thuhet se Kosova ka mundur të zhvilloj politika të shëndosha të bazuara në hulumtime të kualitetit të lartë. Pavarësisht këtyre hulumtimeve, organet qeverisëse nuk kanë zhvilluar një dokument strategjik, i cili do të përfshinte faza të ndryshimeve dhe zhvillimeve të reja në fushën e drejtësisë si në aspektin e organizimit të sistemit, ndërtim të kuadrove, themelimit të mekanizmave jashtë-gjyqësor, apo eliminimit zvogëlimit të kompleksitetit në rrafshin e legjislacionit parësorë dhe dytësorë.

Mungesa e një strategjie gjithëpërfshirëse ka bërë që institucionet të krijojnë institute dhe mekanizma të ri, të ri-dizajnojnë procedura dhe mekanizma ekzistues, dhe të ndër marrin aktivitete tjera në baza ad-hoc dhe duke reaguar sipas nevojës. Rrjedhimisht, akterët relevantë nuk kanë qëndrim të unifikuar rreth qëllimit të reformës, por të gjithë pak a shumë pajtohen në një pikë se “reforma e gjyqësorit ka pasur për qëllim ngritjen e efikasitetit në sistem të drejtësisë.”²⁰

¹⁶ *Shënim:* Grupi Kryesor i Vlerësimit Gjyqësor ishte përbërë nga G. N. Rubotham, Drejtor i Reformës dhe Zhvillimit, Shërbimi i Gjykatave në Irlandë; Lis Sejr, Gjyqtare e Gjykatës së Lartë Perëndimore e Danimarkës; John Tunheim, Gjyqtar Qarku i Shteteve të Bashkuara për Qarkun e Minesotës në Sh.B.A.; Elizabeth C. Eiggins, Bashkëpunëtoare e lartë kërkimi, Qendra Gjyqësore Federale në Sh.B.A.; dhe Markus B. Zimmer, Administrator në Gjykatën e Qarkut të Shteteve të Bashkuara për Qarkun e Utah.

¹⁷ *Shënim:* Letra e z. Michael Steiner, PSSP, drejtuar znj. Renate Einter, Kryetare e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës.

¹⁸ G.n.Rubotham et al., *Sistemi Gjyqësor i Kosovës: Vlerësim dhe Opsione të Propozuara 2003-2004*, Seksioni IX Organizimi dhe kuadri juridiksional i sistemit të gjykatave në Kosovë (Prishtinë: 2004), f. 257.

¹⁹ Seria e katër vOLUMEVE të publikimeve të ABA ROLI-t, Indeksi i Reformës Gjyqësore për Kosovën.

²⁰ IKD intervista me z. Hajredin Kuci, Ministër i Drejtësisë, z. Enver Peci, Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Ismet Kabashi, Kryetar i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Fejzullah Hasani, Kryetar i Gjykatës Supreme, z. Albert Avdiu, Drejtor i Sekretariatit të KGJK-së, z. Shkëlzen Maliqi, Drejtor i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe të tjerë.

Për shkak të mungesës së strategjisë nuk ka pasur koordinim të mirë të iniciativave duke ndikuar edhe në nivelin e suksesit të reformës. Për shembull, procesi i ri-emërimit dhe emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve sigurisht se është dëmtuar nga mungesa e ofertës dinjitoze, ku shumë jurist me nam nuk e kanë parë të arsyeshme të ndërtojnë karrierën në sistem gjyqësor apo prokurorial. Kjo ka qenë pasojë e fillimit të procesit të ri-emërimit dhe emërimit përpara se të definohej statusi i gjykatësve dhe prokurorëve, përfshirë këtu pagat dhe përgjegjësitë, si dhe para definimit të strukturës organizative .

I vetmi dokument publik i cili përmbledh në një faqe e gjysmë angazhimin e Qeverisë për të adresuar nevojat dhe sfidat e reformës të sistemit të drejtësisë është Dokumenti i Politikave Prioritare 2014-2016, i cili përmban këto elemente:

“- Krijimin dhe avancimin e kornizës ligjore dhe institucionale në funksion të sundimit të rendit dhe ligjit në pajtueshmëri me prioritetet që dalin nga procesi i integritetit evropian

- Avancimi i mëtejshëm i sistemit të ndihmës dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtar
- Sigurimi i parakushteve dhe administrimi më efikas i sistemit të ekzekutimit të sanksioneve penale
- Zhvillimi i një sistemi gjyqësor që do të jetë transparent duke siguruar funksionalizim të plotë të reformës gjyqësore në pajtim me ligjet e aplikueshme
- Krijimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike “²¹

Këto politika prioritare kanë mbetur vetëm në letër pasi që ndarjet buxhetore nuk përputhen me këto deklaratat.

Në mungesë të një vizioni gjithëpërfshirës, kontributi i ekspertëve vendorë, komunitetit ndërkombëtar, misionëve të tyre, dhe donatorëve të ndryshëm ka luajtur rol të rëndësishëm në formësimin e kësaj reforme. Këtu janë imponuar praktika të vendeve të ndryshme, gjë që paraqet sfida duke ndikuar në funksionimin dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë në Kosovë. Sistemi i drejtësisë penale në Kosovë ndikohet nga shumë sisteme juridike përfshirë këtu ato Gjermane, Franceze, Amerikane, dhe të tjera. Nëse shohim Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale do të vërejmë një sistem të përzier të drejtësisë me praktika dhe institute të ndryshme të sistemit gjerman, francez, italian dhe anglosakson. “Kodi i Procedurës Penale në disa nga pjesët e tij trashëgon kulturë të pastër Amerikane, siç është futja e institutit të negociimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Ndërsa, praktika e Konventës Evropiane të të Drejtave të njeriut gjendet e shprehur gjithandej ligjit, e në veçanti në krijimin e një sistemi të balancuar të forcave të palëve në procedurë penale.”²²

Mënyra e bërjes së ligjeve pa politika dhe pa strategji është duke e përcjellë edhe tani procesin e reformës në përgjithësi. “Edhe tani vazhdohet njëjtë, flitet për një Dhomë të Veçantë për Krime të Rënda, mirëpo nuk ekziston një koncept analizë, Kështu vazhdohet me solucione Ad-hoc.”²³

²¹ Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme 2014-2016 (Prishtinë: Zyra e Kryeministrit, 5 prill 2013), f. 23 dhe 24.

²² IKD komunikim përmes e-mailit me z. Kujtim Kërveshi, Ekspert Juridik.

²³ IKD intervistë me z. Albert Avdiu, Drejtor i Sekretariatit të KGJK-së.

Rrjedhimisht ligje që ndërlidhen me reformën janë parë si problematike qysh në fazën e planifikimit të zbatimit dhe tanimë pa kaluar as një vit prej hyrjes në fuqi janë duke u zhvilluar takime për ndryshime përmbajtjesore.

III. REFORMA LEGJISLATIVE

Sistemi i drejtësisë pas luftës ka kaluar nëpër reforma të vazhdueshme. Para shpalljes së pavarësisë, Kosova ka pasur probleme shumë të mëdha me sistemin juridik tejet të komplikuar. Ky sistem ishte i përbërë nga nivele të ndryshme të “ligjit të zbatueshëm”, që kishte krijuar pasiguri juridike.²⁴ Deri në shpallje të pavarësisë, arritje e madhe e reformës ligjore ka qenë hartimi dhe hyrja në fuqi e Kodit të Përkohshëm Penal dhe Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale në vitin 2004. Me këto dy kode dhe hyrjen në fuqi të ligjeve sikurse ai për Familjen, Trashëgimin, dhe ligje të tjera, infrastruktura ligjore është përmirësuar deri në një masë.²⁵

Hyrja në fuqi e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nxjerrja e ligjeve të reja ka mënjanuar deri në një masë kompleksitetin e sistemit juridik. Kushtetuta ka përcaktuar Kosovën si Republikë demokratike, që bazohet në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit dhe balancit në mes tyre.²⁶ Për herë të parë pushteti gjyqësor në Kosovë përcaktohet si unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat, duke shënuar progresin më të madh në sigurimin e pavarësisë të këtij pushteti.²⁷ Përveç pavarësisë për gjyqësorin, Kushtetuta kishte paraparë edhe pavarësimin e sistemit prokurorial përmes themelimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Kushtetuta kishte hapur rrugë për një reformë mjaftë të thellë të sistemit të drejtësisë duke e bërë të qartë vizionin për modelin e qeverisjes së vendit. Rrjedhimisht, reforma legjislative dhe gjyqësore ka përfshirë hartimin dhe ndryshimin e një numri të madh të ligjeve.²⁸ Të gjitha këto ligje synojnë të ndikojnë në krijimin e parashikueshmërisë dhe sigurisë juridike në Kosovë.

Hartimi dhe hyrja në fuqi e katër ligjeve bazike të sistemit të drejtësisë,²⁹ është zvarritur kryesisht për shkak të mospajtimeve të Qeverisë dhe komunitetit ndërkombëtarë rreth strukturës së gjykatave, ku këta të fundit insistonin në krijimin e një Gjykate të Apelit në pjesën veriore të Mitrovicës.³⁰ Këto ligje u aprovuan tek në vitin 2010, duke shtyrë përpara pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe sistemit prokurorial. Për më tepër, ligjet përcaktuan edhe strukturën e re të gjykatave dhe prokurorive duke ndryshuar edhe funksionimin e sistemit.

Mandati i përhershëm deri në pensionim i gjykatësve dhe prokurorëve, pagat bazë të nivelizuara me pushtetet tjera, struktura e re e gjykatave me specifikim të kompetencave, krijimi i KPK-së, si dhe risitë tjera ligjore sa i përket sistemit gjyqësor dhe prokurorial kanë qenë disa nga pikat

²⁴ Muharremi R., *Kosova dhe Integrimi i saj në Bashkimin Evropian* (Prishtinë: AUK, 13 prill 2008), f. 5.

²⁵ *Supra note 1*, f. 5.

²⁶ Neni 4, Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

²⁷ *Po aty*.

²⁸ *Supra note 6*.

²⁹ Këtu përfshihen Ligji për Gjykata, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Prokurorin e Shtetit, dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës.

³⁰ Debat televiziv me temën: “Reformimi i sistemit të drejtësisë”. RTK, Emisioni Jeta në Kosovë, 9 korrik 2009. (qasur për herë të fundit me 24 nëntor 2013, <http://jetanekosove.com/sq/Debate/Reformimi-i-sistemit-te-drejtjesise-45>)

kryesore të reformës gjyqësore dhe prokuroriale. Këto elemente kanë siguruar nivel të lartë të pavarësisë. Ndërsa, llogaridhënia ka mbetur e pa adresuar si duhet. Sistemi gjyqësor dhe prokurorial tash për tash mbahen llogaridhënës vetëm përmes mekanizmave të brendshëm, performancë dhe disiplinim. Këto sisteme nuk japin llogari ndaj pushteteve tjera.

Në frymën e një reforme të thellë, është hartuar edhe Kodi i ri Penal dhe Kodi i ri i Procedurës Penale. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës është shpallur në Gazetën Zyrtare vetëm tre ditë para hyrjes në fuqi,³¹ duke shkaktuar kështu probleme të shumta në zbatim të këtij kodi. Zbatuesit e këtij kodi nuk kanë pasur njohuri rreth përmbajtjes dhe zbatimit të tij. Një gjë e tillë ka krijuar kështu pasiguri të madhe në sistemin e drejtësisë për zbatimin e drejtë të tij. Madje as trajnerët nuk e kanë pasur të qartë zbatimin e këtij Kodi.³² Paqartësitë në KPP kishin shkaktuar probleme serioze në funksionim të gjykatave dhe proceseve gjyqësore, ku menjëherë me 7 janar 2013, gjykatësit e Gjykatës Supreme kishin nxjerrë një mendim juridik duke saktësuar procedurat e caktuara me arsyetimin se “dispozitat kalimtare [të KPP-së] janë absolutisht dubioze dhe të paqarta, ...”.³³ Madje, ekspert juridik vlerësojnë se Kodi i Përkohshëm Penal paraprak ka qenë më i mirë në aspektin e ndërtimit të teknikës juridike dhe kompatibilitetit³⁴.

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në kanë hartuar “Termet e Referencës për mekanizmin e përbashkët për vlerësimin e funksionimit të sistemit të ristrukturuar të drejtësisë penale”.³⁵ Tanimë janë mbajtur takime dhe janë mbledhur informata rreth mangësive si dhe nevojave për intervenim në plotësimin e ligjeve të tanishme në këtë fushë. Në përfundim të këtij procesi do të dal një analizë dhe rekomandime “për përmirësimin e efikasitetit, efektivitetit, ekonomisë dhe sistemit të drejtësisë penale, ...”.³⁶

Në vendet post-komuniste, çështjet civile, sidomos ato që ndërlidhen me pronën, janë mjaftë të ndjeshme dhe ka shumë sfida në trajtimin e tyre. Kosova është duke u ballafaquar pikërisht me probleme të cilat deri më tani nuk kanë gjetur zgjidhje adekuate, duke u nisur nga legjislacioni i mangët. Qeveria ka identifikuar si fushë mjaftë të rëndësishme rregullimin e legjislacionit pasi që “çështjet civile nuk janë të definuara mirë, pra, çështja e pronësisë, rregullimi i pronave, llojet e pronave e kështu me radhë”.³⁷ Gjatë viteve në vazhdim, kjo pjesë e reformës së sistemit të drejtësisë duhet të ketë fokus të veçantë, me fokus në kodifikimin e drejtësisë civile. Në këtë drejtim, ligjëbërësit duhet të kenë parasysh edhe avancimin e drejtësisë administrative.

Baza ligjore është në masë të madhe e kompletuar.³⁸ Përkundër zvarritjeve të shumta në përpilimin dhe miratimin e këtyre ligjeve, ato nuk kanë arritur të kenë qëndrueshmëri të gjatë, pasi ende pa

³¹ Kodi i Procedurës Penale është miratuar në Kuvend me 13 dhjetor 2012, është shpallur me dekret të Presidentes me 21 dhjetor 2012, dhe është shpallur në Gazetën Zyrtare me 28 dhjetor 2012. Ndërsa, në fuqi ka hyrë me 1 janar 2013.

³² IKD intervistë me z. Driton Muharremi, Gjykatës në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

³³ Medim Juridik, 15 janar 2013, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

³⁴ IKD intervistë me z. Ismet Salihu, ekspert i së Drejtës Penale.

³⁵ Ky mekanizëm u krijua për të adresuar rekomandimin e Raportit për Liberalizimin e Vizave, që kishte kërkuar pikërisht që gjatë gjysmës së dytë të vitit 2013, të bëhej rishikimi i përgjithshëm i funksionimit të sistemit të ristrukturuar të drejtësisë penale, përfshirë katër ligjet bazike si dhe Kodin e ri Penal dhe Kodin e ri të Procedurës Penale”.

³⁶ Termet e Referencës për mekanizmin e përbashkët për vlerësimin e funksionimit të sistemit të ristrukturuar të drejtësisë penale.

³⁷ IKD intervistë me z. Hajredin Kuci, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Drejtësisë.

³⁸ *Po aty*.

hyrë në fuqi janë identifikuar problemet që do të hasen në zbatim. Si rezultat kemi edhe procesin e ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve bazike të gjyqësorit dhe sistemit prokurorial si rezultat i problemeve të paraqitura në zbatim.

IV. REFORMA KADROVIKE NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Reforma kadroviqe assesi nuk guxon të kufizohet vetëm në procesin e ri-emërimit dhe emërimit të gjykatësve. Kjo reformë kërkon politika dhe strategji të qarta të cilat përfshijnë një gamë të institucioneve, përtej atyre gjyqësore dhe prokuroriale.

Gjatë administrimit të UNMIK-ut, sistemi i drejtësisë në Kosovë ishte përbërë nga gjykatës dhe prokurorë, të cilët nuk kaluan nëpër filtra të mirëfilltë të verifikimit dhe testimit. Sistemi i drejtësisë në atë kohë kishte qenë i mbyllur për inkuadrim të kadrove të reja. Gjatë kësaj periudhe, gjykatësit dhe prokurorët vendorë kanë pasur kompetenca të kufizuara dhe vepronin në varësi të skajshme, nën diktatin e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.

Procesi i ri-emërimit dhe emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve është parë si një nga aktivitetet më substanciale për reformim të sistemit të drejtësisë, me qëllim të kthimit të besimit të qytetarëve në sistem. Duke u bazuar në një proces të ngjashëm të zhvilluar në Bosnje dhe Hercegovinë,³⁹ baza juridike për procesin e ri-emërimit dhe emërimit u themelua në vitin 2006.⁴⁰ Ndërsa në vitin 2008, kanë hyrë në fuqi normat ligjore të cilat themeluan Komisionin e Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP), organ që do të merrej me verifikimin dhe vlerësimin e kandidatëve.⁴¹

Sfida më e madhe në procesin e ri-emërimit dhe emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve ka qenë thithja e kadrove profesionale në sistem. Rastet e shumta gjyqësore të prapambetura, korrupsioni dhe favorizimi, dhe mungesa e kompetencës, assesi nuk kanë mundur të zgjidhen me kuadrot ekzistuese, por as me mentalitetin, i cili i ka krijuar këto probleme. Mungesa e ofertës së paqartë dhe në përgjithësi kuadrot jo-profesionale kanë ndikuar negativisht në rezultatet e këtij procesi.

Oferta për kandidatët për gjykatës dhe prokurorë nuk ka qenë joshëse, si për nga aspekti material ashtu edhe për nga paqartësia e statusit të tyre. Nivelizimi i pagave të gjykatësve dhe prokurorëve me ato të dy pushteteve tjera⁴² ka ndodhur tek pas përfundimit të procesit të ri-emërimit. Rrjedhimisht, pozitat e gjykatësit dhe prokurorit nuk janë parë si vende pune dinjitoze nga shumë jurist. Në përgjithësi, kualiteti i kandidatëve ka qenë i dobët, ku nga 898 kandidatë, vetëm 418 prej tyre kanë kaluar testin fillestar dhe të etikës, ndërsa vetëm 334 janë emëruar. Procesi kishte

³⁹ Proces ky që ishte zhvilluar nga viti 2002 deri në vitin 2004. IKD intervistë me z. Fejzullah Hasani, Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

⁴⁰ *Rregullore mbi kornizën rregullative për sistemin e drejtësisë në Kosovë, Rregullore numër 2006/25, Neni 7 "Reforma gjyqësore"*, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, 27 prill 2006.

⁴¹ *Urdhëresë administrative për Zbatimin e rregullores së UNMIK-ut numër 2006/25 mbi kornizën rregullative për sistemin e drejtësisë në Kosovë, Urdhëresa administrative numër 2008/2*, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, 17 janar 2008.

⁴² Nivelizimi i pagave është siguruar me Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit, të cilat janë miratuar në fund të vitit 2010, dhe këto dispozita për paga kanë hyrë në fuqi tek në vitin 2011.

përfunduar me 274 gjyqtarë dhe 60 prokurorë të ri-emëruar dhe emëruar, duke lënë kështu 98 pozita për gjykatës dhe 29 pozita për prokurorë të pa plotësuar.⁴³

Pavarësisht nismës që kishte filluar qysh më herët, institucionet kishin dështuar të bënin përgatitje të kuadrove të reja, të cilat do i bashkoheshin sistemit të drejtësisë, ku “në Kosovë nuk ka mungesë të juristëve, por ka mungesë të juristëve të mirë”.⁴⁴ Një gjë e tillë kishte ndikuar që niveli i përgjithshëm i kandidatëve për pozita të gjykatësve dhe prokurorëve të mos jetë profesional dhe të mbesin një numër i madh i pozitave pa u plotësuar. Ndër vite, numri i institucioneve të larta të arsimit, në kuadër të cilave funksionojnë Fakultetet Juridike, është shtuar. Kjo mund të jetë një mundësi që në të ardhmen si rezultat i konkurrencës të kemi përmirësim të edukimit ligjor të juristëve të ri. Përveç arsimit formal, është tejet i nevojshëm edhe zhvillimi i shtegut për karrierë në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, i cili nuk ekziston tash e sa kohë. Përgjegjësinë për këtë dështim e mbajnë institucionet gjyqësore, prokuroriale si dhe ato qeveritare. Sistemi i drejtësisë duhet të përgatisë shkallët e ngritjes në karrierë, të cilat do të bëjnë që në mënyrë natyrale të ndërtohen kuadrot profesionale para se të vijnë në pozitën e gjykatësit dhe prokurorit, që të kenë njohuri të mëdha sa i përket interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në frymën e përgatitjes së gjykatësve dhe prokurorëve, Instituti Gjyqësor i Kosovës luan rol të rëndësishëm. Ngritja e kapaciteteve dhe kualitetit të trajnimeve në IGJK është qenësore për të siguruar kualitet të mirë të kuadrove në të ardhmen. Në këtë aspekt, është duke u zhvilluar debat i madh rreth formimit të Akademisë së Drejtësisë, një akademi më e specializuar për trajnim dhe edukim.

Ndikimet politike assesi nuk kishin qëndruar larg procesit të reformimit të sistemit të drejtësisë, përkatësisht procesit të riemërimit dhe emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve, proces ky për filtrimin e bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale. Emërimet dhe refuzimet mbi baza politike u theksuan edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian të vitit 2011. Lista e përpiluar me propozimet e KGJK-së për emërimin e gjykatësve ishte shkurtuar në fund nga ish-ushtuesi i Presidentit në Detyrë, z. Jakup Krasniqi.⁴⁵

E metë tjetër e procesit të reformimit të kuadrove në kuadër të procesit të riemërimit dhe emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve, padyshim se mbeten kriteret e përcaktuara të emërimit. Përvoja e punës e vendosur për emërimin e nivelit të gjykatësve apo prokurorëve të nivelit suprem ka qenë e pakapshme për një numër të juristëve të dëshmuar profesionalisht në Kosovë. Rrjedhimisht, përvoja e punës e kërkuar prej 12 vjetësh ka eliminuar kandidatë të shumtë të rinj, sepse kriterin e përvojës prej 12 vitesh si gjykatës apo prokurorë kanë mundur ta plotësojnë vetëm kuadrot që kanë punuar edhe në sistemin e kaluar komunist gjyqësor, por këtë kriter ka qenë e pamundur ta plotësojnë kuadrot e reja ligjore, të cilat janë kyçur në sistemin gjyqësor vendor pas luftës.⁴⁶

Një problem mjaftë i rëndë ku reforma nuk mund të jetë e kompletuar është edhe çështja e administratës gjyqësore. Kemi administratë në gjyqësor të mjaftueshme në proporcion me

⁴³ *Raporti i punës së KPGJP-së* (Prishtinë: Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, 29 tetor 2010), f. 2.

⁴⁴ IKD intervistë me z. Hajredin Kuci, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Drejtësisë. *Supra note 26*, f. 10.


⁴⁵ *Raporti i Progresit për Kosovën 2010* (Bruksel: Komisioni Evropian, 2010).

⁴⁶ Musliu, B., *Procesi i ri-emërimit dhe emërimit, pavarësia dhe ndikimet: Riemërimi dhe emërimi i gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë* (Prishtinë: Instituti i Kosovës për Drejtësi, gusht 2011).

gjykatësit, tre persona për një gjykatës.⁴⁷ Mirëpo, problemi kryesor qëndron në strukturën e gjyqësorit, ku nuk janë caktuar pozita të mjaftueshëm për staf profesional. Këtu ka ndikuar negativisht politika që gjatë reformës të mos ketë përjashtim nga puna por të gjithë punonjësit të risistemohen.⁴⁸ Në sistem gjyqësor dhe prokurorial, administrata është mjaftë e rëndësishme, pasi që kryen një punë shumë të madhe në përgatitjen e rasteve dhe lëndëve, në kuptimin e punëve administrative. Rrjedhimisht, është tejet shqetësuese një administratë e cila është trashëguar nga e kaluara, duke pasur parasysh se pas luftës degradimi në gjyqësor është mundur pikërisht edhe për shkak të administratës së tillë. Prandaj, procesi i reformës kadrovike, e cila ka përfshirë gjykatësit dhe prokurorët, përmes procesit të riemërimit dhe emërimit është dashur të krijojë një mekanizëm dhe një proces, i cili do të merrej edhe me punonjësit e stafit mbështetës të gjykatave dhe prokurorive. Madje mosfiltrimi i kësaj pjese të punonjësve, të cilët vlerësohen të pazëvendësueshëm në procesin e punës për gjykatësit dhe prokurorët, vlerësohet si një ndër dështimet më të mëdha.⁴⁹ Keqpërdorimet më të mëdha të detyrës zyrtare, dhe dyshimet për veprimtari të shumta korruptive, natyrshëm vlerësohet se nuk mund të kryhen vetë as nga gjykatësit e as nga prokurorët, pa pasur bashkëpunim të ngushtë me stafin e tyre mbështetës. Dhe në të kaluarën janë akuzuar persona nga stafi mbështetës, të cilët kanë kryer madje punë në emër të gjykatësve dhe prokurorëve.⁵⁰ IKD vlerëson se reforma e administratës gjyqësore dhe prokuroriale, është një nga çelësat kryesorë të forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Takimin e parë me sistemin e drejtësisë, qytetarët e kanë me administratën gjyqësore dhe prokuroriale dhe performanca e saj është thelbësore në klimën e besimit të qytetarëve tek sistemi. Prandaj, filtrimi i punonjësve dhe krijimi i mekanizmave efikas për kontrollin e performancës së tyre mbetet sfidë për institucionet e drejtësisë.

V. REFORMA STRUKTURE DHE PËRKRAHJA ME RESURSE

Reforma e strukturës së gjykatave ka filluar shumë herët, menjëherë pas vitit 1999. Zgjidhja e statusit të Kosovës ka qenë një nga faktorët kyç që e ka lënë këtë reformë të mos ndodh deri tani. Struktura e re ka synuar që të thjeshtësoj sistemin, të mundësoj specializim të gjykatësve dhe prokurorëve, dhe të qartësohen kompetencat sa më shumë që është e mundur. Struktura e re e gjykatave duket kështu:




⁴⁷ IKD intervistë me z. Hajredin Kuci, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Drejtësisë.

⁴⁸ IKD intervistë me z. Sali Mekaj, Kryetar i Gjykatës së Apelit në Prishtinë.


⁴⁹ *Supra note 45.*

⁵⁰ Bajrami S., Shoferi i pazareve, Gazeta Express, 24 gusht 2009.



Shënim: Secila nga shtatë Gjykatat Themelore (Gj.Th.) ka këto departamente Departamentin e Përgjithshëm, Departamentin për Krime të Rënda, dhe Departamentin për të Mitur. Ndërsa, vetëm Gjykata Themelore në Prishtinë ka edhe dy departamente tjera shtesë Departamentin për Çështje Ekonomike dhe Departamenti për Çështje Administrative. Gjykatat Themelore kanë 20 degë: Prishtina (4), Mitrovicë (4), Pejë (3), Gjakovë (2), Prizren (2), Gjilan (3), dhe Ferizaj (2).

Ndërsa struktura e prokurorive është kjo:



Shënim: Secila Prokurori Themelore ka nga tre Departamente: Krime të Rënda, Krime të Përgjithshme, dhe të Mitur. Strukturimi i këtillë i gjykatave në shtatë Gjykata Themelore, një të Apelit, dhe Gjykatën Supreme, ka mundësuar koncentrik të gjykatave, mundësi për specializim të mëtutjeshëm të gjykatësve dhe prokurorëve. Njëkohësisht themelimi i degëve ka mundësuar që në raste të nevojshme degët të shërbejnë për qasje më të lehtë në drejtësi për qytetarët. Megjithatë, struktura e re nuk ka adresuar në mënyrën më të mirë çështjet e krimeve të rënda dhe lëndët administrative. Për çështjen e

krimeve të rënda kërkohet stimulim dhe trajtim më i veçantë i gjykatësve që do merren me ato lëndë, pasi që dallimi i pagës në mes të Departamentit të Përgjithshëm dhe atij për Krime të Rënda është 20 Euro. Ky dallim i vogël në pagë nuk i bën gjykatësit të synojnë departament me përgjegjësi më të mëdha. Ndërsa për çështje administrative kërkohet patjetër specializim i theksuar. Pavarësisht kohës së afërt kur ka hyrë në fuqi struktura e re, kemi debate të shumta të cilat janë duke na drejtuar kah krijimi i Gjykatës së Veçantë për Krime të Rënda, si dhe shqyrtimit të nevojës për krijim të Gjykatës Administrative. Për krijimin e Gjykatës Ekonomike/të Lartë Administrative si dhe Gjykatës për Krime të Rënda pajtohet edhe Kryetari i Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke theksuar nevojën për krijim të kuadrit të veçantë.⁵¹

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2014-2016 nuk është në përputhje me prioritetet e deklaruara në DPP 2014-2016, ku dështon të parasheh resurse financiare adekuate për të krijuar dhe përmirësuar infrastrukturën fizike të gjykatave. Me planifikimet e tanishme dhe trendin e ndarjeve buxhetore, ky qëllim do të përmbushet tek në vitin 2028.⁵² Ndërsa, KASH 2014-2016 parasheh se me ndarjet buxhetore do të ketë ndërtime të Gjykatave Themelore në Ferizaj, Vushtri,⁵³ Gjakovë, dhe Pejë,⁵⁴ që është plotësisht në kundërshtim me planet e punës dhe planet buxhetore të KGJK-së.⁵⁵

Përderisa me ligj është bërë koncentrimi i gjykatave, në praktikë një gjë e tillë nuk është mundësuar. Kjo për shkak se GjTh e Prishtinës funksionon në katër objekte, GjTh në Pejë në 2 objekte, GjTh në 2 objekte, dhe GjTh Prizren në 2 objekte. Përveç GjTh Prishtinë, të tjerat nuk kanë ndonjë problem të theksuar në procesin e veprimit.⁵⁶ Gjykata Themelore e Prishtinës nuk ka pasur përgatitje minimale për reformë.⁵⁷ “Reforma ka kërkuar kushte të reja dhe përkrahje me numër të madh të gjykatësve dhe staf mbështetës.”⁵⁸

VI. ÇËSHTJE TJERA

a. Cënimi i pavarësisë së gjyqësorit

Reformat në sistemin e drejtësisë në Kosovë kanë kontribuar shumë në aspektin e sigurimit të pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Aspektet pozitive të pavarësisë së gjyqësorit u përmendën edhe më lartë. Në këtë sferë kanë hyrë zgjidhja e statusit të bartësve të funksioneve gjyqësore ku është siguruar mandati i përhershëm, paga më dinjitoze, si dhe është krijuar Këshilli Prokurorial i Kosovës.

⁵¹ IKD intervistë me z. Hamdi Ibrahim, Kryetar i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

⁵² IKD intervistë me z. Albert Avdiu, Drejtor i Sekretariatit të KGJK-së.

⁵³ Sistemi gjyqësor i Kosovës nuk ka Gjykatë Themelore të Vushtrrisë, por vetëm degë të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, gjë që e bën konfuz këtë pjesë se çfarë do të ndërtohet në Vushtri.

⁵⁴ *Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2014-2016* (Prishtinë: Ministria e Financave), f. 177.

⁵⁵ Sipas Albert Avdiut, ndërtimi i objektit për një gjykatë themelore është rreth 2.5 – 3.0 Mil Euro, ku sipas trendeve të shpenzimeve kapitale, mundësitë e KGJK-së janë që një objekt të tillë ta ndërtoj cdo tre vjet. IKD intervistë me z. Albert Avdiu, Drejtor i Sekretariatit të KGJK-së.

⁵⁶ IKD intervistë me z. Albert Avdiu, Drejtor i Sekretariatit të KGJK-së.

⁵⁷ IKD intervistë me z. Hamdi Ibrahim, Kryetar i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

⁵⁸ *Po aty*.

Në anën tjetër, janë disa çështje mjaftë të rëndësishme të cilat kanë mbetur nën ndikimin e madh të pushteteve tjera. Në këtë frymë, resurset e mangëta për gjyqësorin mund të konsiderohen cenim i pavarësisë së Gjyqësorit, përkatësisht sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Ligjet bazike të gjyqësorit nuk kanë mundur të zbatohen me sukses pasi që nuk janë përcjellë me përkrahje adekuate me resurse financiare, njerëzore dhe resurse tjera. Ekzekutivi dhe legjislativi kanë shprehur vullnet të vogël për të përkrahur me resurse gjyqësorin, dhe kjo jo për shkakun e buxhetit të vogël të shtetit. Sa për ilustrim, me buxhetin e tanishëm dhe parashikimet për të ardhmen, gjyqësori mund të përfundoj ndërtimin e ndërtesave sipas kërkesave ligjore tek në vitin 2028. Cenim i pavarësisë së Gjyqësorit konsiderohet çdo veprim i Ekzekutivit apo Legjislativit i cili minon efikasitetin e punës së gjyqësorit si pasojë e resurseve të mangëta që ndahen për gjyqësorin. (Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut).⁵⁹

Përveç mungesës së përkrahjes për kushtet institucionale, gjykatësit dhe prokurorët në Kosovë në vazhdimësi janë kërcënuar sa i përket sigurisë financiare personale të tyre. Pa u mbushur dy vjet nga nivelizimi i pagave të gjykatësve dhe prokurorëve, në vitin 2012, Qeveria kishte miratuar Projektligjin për Pagat e Funkionarëve Publikë që kishte degraduar të ardhurat e përfaqësuesve të gjyqësorit në krahasim me ato të përfaqësuesve të pushteteve tjera. Kuvendi kishte miratuar kthimin prapa të këtij projektligji degradues, duke vlerësuar drejtë shqetësimet e gjykatësve dhe prokurorëve. Poashtu, aspekt tjetër i sigurisë financiare është edhe pensioni prej 112 Eurove në muaj i gjykatësve dhe prokurorëve, e cila paraqet një pasiguri financiare që shfaqet si rrezik për ushtrimin e drejtë dhe të paanshëm të punës së gjykatësit gjatë mandatit të vet.

b. Llogaridhënia gjatë procesit të ri-emërimit dhe emërimit

Mekanizmi për disiplinimin e gjykatësve dhe prokurorëve nuk kanë qenë efikas dhe efektiv në ndjekjen e sjelljeve të pahijshme të bartësve të funksioneve gjyqësore. Në kohën e UNMIK-ut ndër vite kishte funksionuar Njësia e Inspeksionit Gjyqësor,⁶⁰ e cila më vonë përmes një rregulloreje tjetër të UNMIK-ut ishte transformuar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor.⁶¹ NJAGJ sa më shumë që është sfiduar me parashtrësia ka vazhduar të dështoj në zhvillimin e hetimeve dhe përgatitje të raporteve. Në vitin 2007 kur janë paraqitur 604 parashtrësia, NJAGJ ka arritur të përgatis vetëm 11 raporte.

Llogaridhënia kishte munguar pothuajse në tërësi përgjatë procesit të riemërimit dhe emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve. Përgjegjësia dhe llogaridhënia në punë e gjykatësve dhe prokurorëve nuk kishte ekzistuar pothuajse fare.⁶² Në këtë fazë një pjesë e gjykatësve dhe prokurorëve që kishin

⁵⁹ Gashi A. dhe Musliu B. Pavarësia e gjyqësorit në Kosovë: Analizë e pavarësisë financiare institucionale dhe individuale. (Prishtinë: Instituti i Kosovës për Drejtësi, nëntor 2012). F. 5.

⁶⁰ Njësia e Inspeksionit Gjyqësor ishte themeluar me Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut numër 2001/4 me datë 11 maj 2001 për zbatimin e Rregullorës së UNMIK-ut numër 2000/15 (neni 1) mbi Themelimin e Departamentit të Drejtësisë si shërbim përgjegjës për inspektim, revision dhe hetime në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës.

⁶¹ Me UA, Nr. 2008/7, datë 14 qershor 2008, Për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/52 Mbi Kornizën Rregullative për Sistemin e Drejtësisë në Kosovë, ish NJIGJ transformohet në ZPD në kuadër të Departamentit të Drejtësisë me mandat (Neni 21. a) “që të hetojë aktivitetet e gjyqtarëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve porotë që punojnë në sistemin gjyqësor dhe të prokurorisë, pavarësisht se a është bërë ndonjë ankesë ndaj tyre apo jo” dhe (b) “të ndjek rastet e sjelljes së keqe para organeve përkatëse disiplinore të gjyqësorit dhe prokurorisë”.

⁶² *Supra note 26.*

rënë në testin e etikës dyshohet se kishin keqpërdorur detyrën gjatë pjesës së mbetur të mandatit. Askush nuk ishte mbajtur përgjegjës për keqpërdorimet e pretenduara.⁶³

Tek pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për Këshillin Prokurorial kanë filluar të krijohen mekanizmat për kontrollin e cilësisë së punës për gjykatësit dhe prokurorët. Tashmë ekzistojnë mekanizmat që bëjnë kontrollimin e kuantitetit dhe kualitetit të punës së gjykatësve dhe prokurorëve. Vlerësimi i cilësisë së punës së gjykatësve dhe prokurorëve është bërë për gjykatësit dhe prokurorët, të cilat kanë pasur mandat fillestar, dhe të cilët kishin kandiduar për mandat të përhershëm në vitin 2013. Vlerësimi i bërë për këto kuadro të reja tregon për një kualitet jo shumë të mirë, të paktën në anën e prokurorëve, ku mbi 90% prej prokurorëve me mandat fillestar u është kumtuar se duhet të vijojnë trajnime të detyrueshme për të vazhduar me mandatin e tyre të përhershëm. Ndërsa për gjykatësit ekzistojnë mendime të ndryshme, ku më pak se 15% e gjykatësve me mandat fillestar janë detyruar të mbajnë trajnime shtesë për të vazhduar pastaj mandatin e përhershëm. Kryetarët e Gjykatave kanë mendime të ndryshme sa i përket vlerësimeve të Komisionit për Vlerësim të Performancës së Gjykatësve, ku disa i vlerësojnë se pjesa e madhe e gjykatësve i plotësojnë vetëm kushtet minimale⁶⁴ dhe disa të tjerë kanë mendim ndryshe duke theksuar se këta gjykatës plotësojnë kushtet në nivel të kënaqshëm.⁶⁵

c. Avokatia në Kosovë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka sistemuar avokatinë në kuadër të Kapitullit të Sistemit të Drejtësisë. Avokatia në Kosovë është pjesë përbërëse e institucioneve të drejtësisë që ndikon drejtpërdrejtë në sundimin e ligjit në vend. Deri në vitin 2009, avokatura kishte funksionuar sipas ligjit të vitit 1979.⁶⁶ Në vitin 2009, ka hyrë në fuqi Ligji për Avokatinë,⁶⁷ i cili ishte zëvendësuar me ligj të ri në vitin 2013. Avokatia si pjesë përbërëse e sistemit të drejtësisë është përfshirë në debate të shumta për tu reformuar dhe vazhdimisht është ngritur nevoja e arsimimit ligjor të avokatëve, ngritjen e tyre profesionale, zhvillimi i shkathtësive praktike të avokatëve, si dhe forcimin e etikës profesionale. Në këtë drejtim kanë dhënë kontribut të vazhdueshëm organizatat ndërkombëtare në Kosovë.

Gjatë procesit të ri-emërimit dhe emërimit, pjesa dërrmuese e gjykatësve dhe prokurorëve që nuk janë ri-emëruar janë licencuar si avokat. Oda e Avokatëve të Kosovës nuk ka pasur mjet për të filtruar gjykatësit dhe prokurorët që kanë rënë në testin e integritetit, duke lejuar kështu funksionimin e tyre si avokat. Në këtë mënyrë, këta prokurorë dhe gjykatës kanë pasur mundësinë që përmes avokatisë të jenë sërish pjesë e sistemit të drejtësisë.⁶⁸ Kjo e ka dëmtuar në masë të madhe kredibilitetin e OAK-ut dhe profesionin e avokatisë në Kosovë.

⁶³ *Supra note 26.*

⁶⁴ IKD intervistë me z. Hamdi Ibrahim, Kryetar i Gjykatës Themelore të Prishtinës.

⁶⁵ IKD intervistë me z. Sali Mekaj, Kryetar i Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

⁶⁶ Ligjin mbi Avokaturën dhe Ndihmën tjetër Juridike, Gazeta Zyrtare e KSAK, nr. 011-69/79.

⁶⁷ Ligji për Avokatinë. Nr. 03/ L-117 i datës 12 shkurt 2009. Kuvendi i Kosovës.

⁶⁸ *Supra note 26.*

Për të shtuar kredibilitetin e komunitetit të avokatëve në Kosovë, duhet një mbikëqyrje më e madhe e sistemit të avokatisë dhe zbatim i akteve dhe shtim i efikasitetit në mekanizmin disiplinor.

d. Shërbimi korrektues dhe provues

Pjesë e arkitekturës së madhe të sistemit të drejtësisë është Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ky shërbim vazhdimisht është përballur me probleme të natyrave të ndryshme në aspektin e menaxhimit të sigurisë në institucionet korrektuese por edhe në plotësimin e kushteve për të dënuarit që vuajnë dënimet, në kuptim të plotësimin të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Së fundi është ndërtuar Burgu i Sigurisë së Lartë me standarde të larta, i cili do të ofrojë kushte më të mira për një pjesë të të dënuarve. Në kuadrin e institucioneve të drejtësisë, organet qeverisëse kanë shënuar progres në krijimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës, shërbim ky i vetmi në Rajon, i cili merret me risocializimin e të dënuarve, të cilët dalin nga burgjet.

VII. INDIKATORËT

Institucionet e drejtësisë, përfshirë këtu MD-në, KGJK-në, KPK-në si dhe institucionet e tjera nuk kanë një listë të indikatorëve për të vlerësuar ndikimin e reformës. Në mungesë të indikatorëve të tillë, IKD ka synuar të krijojë disa indikatorë bazuar në çështjet më të rëndësishme në të cilat reforma ka synuar të ketë ndikim. Indikatorët janë plotësuar në bashkëpunim me zyrtarët e SKGJK-së, SKPK-së, MD-së, Komisionit për Ndërmjetësim, Arbitrazh, dhe Noteri si dhe duke iu referuar dokumenteve të ndryshme të publikuara nga këto institucione.

a. Indikatorët për Sistemin Gjyqësor

Emri i indikatorit të projekteve/rezultateve		Pika bazë/ e referencës	Tani	Qëllimi përfundimtar
Rikonstruktimi fizik i gjykatave sipas standardeve	Vlera: 6 Gjykata Themelore x €2.5-3 Mil. = €15-18 Mil. (financimi Rep. e Kosovës) Pallati i Drejtësisë (pjesa e gjyqësorit) = €18 Mil. (financimi i BE-së)	Nuk ka pasur objekte të cilat i kanë plotësuar nevojat. 20 objekte që nuk i kanë plotësuar nevojat.	GjTh Gjilan e përfunduar GjTh Ferizaj ka filluar të ndërtohet në 2013 dhe pritet të përfundojë në 2015 Ndërtimi i Pallatit të Drejtësisë është përfunduar 60% e punës, pritet që përfundimisht të përfundojë në korrik 2014	Ndërtimi i 6 Gjykatave Themelore të cilat i plotësojnë nevojat sipas kompetencave të reja. Ndërtimi i Pallatit të Drejtësisë ku do të vendoseshin Gjykata Supreme, Dhoma e Posaçme, Gjykata e Apelit, Gjykata Themelore Prishtinë, dhe nëse ka hapësirë po ashtu Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe dega e Graçanicës.
	Data	Viti 2008	Nëntor 2013	Viti 2028
	Koment		Përveç GjTh Gjilan, Gjykatat tjera nuk plotësojnë nevojat,	Në bazë të praktikës së tanishme të ndarjeve buxhetore, gjyqësori

			<p>sidomos Departamentet e Krimeve të Rënda.</p> <p>USAID ka ndihmuar me dy projekte, një në vitin 2007, ku janë ndarë \$ 3 Mil. Për renovim të 10 gjykatave sipas Programit Gjykatat Model, dhe më vonë përmes programit EROL ka financuar renovimin e 20 gjykatave tjera. Megjithatë, këto gjykata nuk janë në përputhje me standardet e caktuara në Gj Th Ferizaj.</p>	<p>mund të ndërtoj çdo 3 vjet një Gjykatë Themelore, gjë që do të pamundësoj ndërtimin e të gjitha objekteve të nevojshme deri në vitin 2028.</p>
<p>Përmirësimi i transparencës (salla të gjykimeve, zëdhënësit nëpër gjykata, uebfaqet, raportimet e rregullta)</p>	<p>Vlera:</p> <p>Paga e vazhdueshme për zëdhënësit.</p> <p>USAID përkrahë zhvillimin e Ueb Portalit.</p>	<p>Asnjë zëdhënës nëpër gjykata.</p> <p>Një zëdhënës në KGJK.</p> <p>Ueb faqja e KGJK-së.</p> <p>Gjykatat nuk kanë ueb faqe.</p> <p>Raportimi statistikor, në baza tre mujore dhe vjetore.</p>	<p>6 zëdhënës të gjykatave janë rekrutuar.</p> <p>1 zëdhënës në KGJK.</p> <p>Zhvillimi i Portalit është në fazën fillestare, kontrata me kompaninë implementuese është nënshkruar.</p> <p>Planifikimet për raportet periodike janë zhvilluar.</p> <p>Publikohet raporti vjetor i KGJK-së, dhe vazhdohet me publikimin e raporteve statistikore.</p>	<p>9 zëdhënës nëpër gjykata.</p> <p>1 zyre kryesore në ndërtesën kryesore me 2 zëdhënës.</p> <p>Portal kryesor, i cili përfshinë edhe ueb faqet për secilën gjykatë.</p> <p>Raportime periodike të zëdhënësve të gjykatave.</p> <p>Raporti vjetor i KGJK-së.</p>
	Data	Viti 2008	Nëntor 2013	Nëntor 2014
	Koment		USAID ka ndihmuar në zhvillimin e ueb faqeve për gjykata të caktuara mirëpo këto ueb faqe nuk janë më funksionale.	

???% zvogëlim të kohës nga fillimi i një rasti deri në përfundim.	Vlera	Nuk ka pasur matje kohore.	Nuk ka ndonjë vlerësim.	Nuk ka ndonjë qëllim të caktuar.
	Data			
	Koment			
Kryerje e lëndëve në kohë	Vlera	Standardet kohore janë hy në fuqi për herë të fundit në vitin 2007.	Janë me standarde 2007, të cilat nuk i përgjigjen numrit aktual të lëndëve, gjykatësve, etj	Standarde kohore të rishikuara. Lëndët do të zgjidhen 100% brenda standardeve kohore.
	Data	2007	Nëntor 2013	Nuk është caktuar afat.
	Koment			
Zhvillimi dhe zbatimi i standardeve për implementim të reformës (dokumente strategjike për reformë)	Vlera	Nuk ka pasur.	Është zhvilluar plani i veprimit për zbatim të ligjeve bazike.	Plan veprimi për ligjet bazike. Strategji për sistemin e drejtësisë.
	Data	2007	Nëntor 2013	Nuk është caktuar afat.
	Koment			
Programi softuerik për grumbullim të të dhënave është në vend (SIML)	Vlera: 2.5 Milion Euro për projektin fillestar 7 Milion Euro për projektin e tanishëm	SIML i përfunduar nuk është funksionalizuar kurrë i tëri.	Është përfunduar programi kompjuterik mirëpo nuk është funksionalizuar në plotësi dhe me ndërrimin e teknologjisë është paraqitur nevoja për zhvillim të një programi tjetër. Për programin e ri: Kontraktimi i kompanisë është bërë.	Funksionalizimi i plotë i SIML.
	Data	2002-2003		2020
	Koment		SIML është zhvilluar më parë mirëpo për shkak të mungesës	

			së përdorimit nga ana e gjykatësve ky projekt nuk është zbatuar në praktikë, kjo ka ndodhur para vitit 2010 kur edhe është bërë reforma kadrovike.	
Praktikat më të mira të buxhetimit janë në vend dhe zbatohen	Vlera	Buxheti i centralizuar	Planifikimi dhe shpenzimi i buxhetit vazhdon të jetë i centralizuar	Performancë e bazuar në indikatorë.
	Data		Nëntor 2013	Nuk ka ndonjë afat të caktuar.
	Koment			
Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi Civil janë amendamentuar/hartuar dhe janë në fuqi	Vlera	Kodi i vjetër Penal dhe Kodi i vjetër i Procedurës Penale.	Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale është i ndryshuar dhe është në fuqi.	Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi Civil janë hartuar dhe janë në fuqi.
	Data		Nëntor 2013	Janar 2017
	Koment	Në vitin 2003 është miratuar ndërsa në vitin 2004 ka hyrë në fuqi Kodi Penal.		
Vlerësimi i Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Civil	Vlera	Nuk ka vlerësim	Janë përpiluar Termat e referencës për mekanizmin e përbashkët për vlerësimin e funksionimit të ristrukturuar të drejtësisë penale (KGJK, MD, dhe KPK) Është përfunduar faza e parë e punës së Mekanizmit të Përbashkët që ka dalur nga këto Terma të referencës.	Publikimi i Raportit përfundimtar për vlerësimin e sistemit të drejtësisë penale dhe civile

	Data		Nëntor 2013	Janar 2018
	Koment			
Amandamenti/bërja e ligjeve për Gjykatat dhe Këshillin Gjyqësor	Vlera	Kanë qenë në fuqi ligjet e vjetra, ai i vitit 1978, rregullore 1981, 1999, UNMIK 2000.	Ligjet e reja janë miratuar dhe janë në fuqi.	Ligji për Gjykatat dhe Këshillin Gjyqësor janë në fuqi.
	Data	2008	Nëntor 2013	Janar 2011 dhe Janar 2013.
	Koment			
Vlerësimi i ligjeve për Gjykatat dhe Këshillin Gjyqësor	Vlera	Nuk ka vlerësim.	Janë përpiluar Termat e referencës për mekanizmin e përbashkët për vlerësimin e funksionimit të ristrukturuar të drejtësisë penale (KGJK, MD, dhe KPK) Është përfunduar faza e parë e punës së Mekanizmit të Përbashkët që ka dalur nga këto Terma të referencës.	Publikimi i Raportit përfundimtar për vlerësimin e sistemit të drejtësisë penale.
	Data	Janar 2013	Nëntor 2013	Korrik 2014
	Koment			
???% zvogëlim të lëndëve të pazgjidhura	Vlera	200,000 lëndë të vjetra. Nuk ka strategji për zvogëlim të lëndëve.	Janë hartuar dy strategji: - Strategjia e nëntorit 2010 - Strategjia e gushtit 2013 222,000 lëndë të pazgjidhura.	Përcaktimi se çfarë është lëndë e vjetër. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj Strategjie është reduktimi sa më i madh i lëndëve të vjetra me të cilat përballen gjykatat e Kosovës
	Data	2009	Nëntor 2013	Nuk ka afat të caktuar.
	Koment			

???% e rritjes së besimit të qytetarëve	Vlera	Nuk ka vlerësim se sa është besimi i qytetarëve në sistem. Janë disa sondazhe të UNDP-së dhe USAID të cilat nuk merren për bazë nga institucionet.	Nuk ka ende ndonjë zhvillim.	Publikimi i raporteve periodike.
	Data			
	Koment	2004, 2005, dhe 2006.	Nëntor 2013	Nuk ka afat të caktuar.
Themelimi i Mekanizmave jashtë-gjyqësorë (Ndërmjetësimi, Noteria, Arbitrazhi, përmbaruesit privat)	Vlera	Nuk ka pasur	Është themeluar instituti i ndërmjetësimit (99 ndërmjetësues të licencuar) Është themeluar instituti i noterisë (68 noterë) Është themeluar instituti i arbitrazhit (janë dy qendra një në Odën Ekonomike të Kosovës dhe një në Odën Ekonomike Amerikane të Kosovës)	Licencimi i ndërmjetësuesve, noterëve, dhe themelimi i qendrave të arbitrazhit. Puna e përmbaruesve privat pritet të filloj në vitin 2014.
	Data	2008	Nëntor 2013	
	Koment			
Funksionalizimi i Mekanizmave jashtë-gjyqësorë (Ndërmjetësimi, Noteria, Arbitrazhi) (sa e kanë liru gjyqësorin nga lëndët)	Vlera	Nuk ka pasur asnjë nga këto institute Noteri, Ndërmjetësim, apo Arbitrazh.	Ndërmjetësimi: Gjatë vitit 2012 raste të referuara nga gjykatat, prokuroritë dhe me vet referim janë 178 raste për ndërmjetësim. Prej tyre janë zgjidhur 76 raste, të pazgjidhura janë 63,ndërsa në proces janë 39. Gjatë vitit 2013, në periudhën janar - nëntor, raste të referuara nga gjykatat, prokuroritë dhe me vet referim janë 432 raste për	Nuk ka ndonjë qëllim për asnjërën nga këto institute.

			<p>ndërmjetësim. Prej tyre janë zgjidhur 216 raste, të pazgjidhura janë 45, ndërsa në proces janë 52 raste.</p> <p>Noteria: e ka liruar sistemin gjyqësor për rreth 50,000 lëndë</p> <p>Arbitrazhi: 5 lëndë janë shqyrtuar.</p>	
	Data		Nëntor 2013	Nuk ka ndonjë afat.
	Koment			
Plotësimi i pozitave të gjykatësve	Vlera	372 pozita të lira	345 gjykatës.	372 gjykatës.
	Data	2009	Nëntor 2013	2010
	Koment			

b. Indikatorët për Sistemin Prokurorial

Emri i indikatorit të projekteve/rezultateve		Pika bazë/ e referencës	Tani	Qëllimi përfundimtar
Rikonstruktimi fizik i prokurorive sipas standardeve (kushtet fizike të punës)	Vlera	Kanë operuar kryesisht nëpër objekte private dhe gjykata.	Prokuroria Themelore në Prizren ndërtesa e kryer. Prokuroria Themelore në Pejë është në fazën përfundimtare të ndërtimit. Pallati i Drejtësisë është në përfundim. Ka filluar ndërtimi i objektit të PTH-Gjilan, Ferizaj dhe Gjakove.	Ndërtimi i 6 Prokurorive Themelore. Ndërtimi i Pallatit të Drejtësisë.
	Data	2008	Nëntor 2013	2014-2016
	Koment			
Përmirësimi i transparencës (zëdhënësit nëpër prokurori, uebfaqet, raportimet e rregullta)	Vlera	Para vitit 2011, asnjë zëdhënës. Pastaj, 1 zëdhënës.	Ueb-faqja e PSH-së funksionale, ndërsa e KPK-së në përfundim. 2 zëdhënës janë rekrutuar (1 KPK dhe 1 PSH). Publikim i raporteve tre-mujore, vjetore, si dhe raporteve tjera tematike për punën e prokurorive.	9 zëdhënës. Ueb-faqja e KPK e funksionalizuar. Publikim i raporteve tre-mujore, vjetore, si dhe raporteve tjera tematike për punën e prokurorive.
	Data	2010	Nëntor 2013	2015
	Koment			

Zhvillimi dhe zbatimi i standardeve për implementim të reformës (dokumente strategjike për reformë)	Vlera	Nuk ka pasur	Plani për zbatimin e ligjit është hartuar dhe zbatuar plotësisht.	Plan për implementimin e ligjit për Prokurorin e Shtetit. Strategjia për gjyqësorin
	Data		Nëntor 2013	5 dhjetor 2011.
	Koment			
Programi softuerik për grumbullim të të dhënave është në vend (SIML)	Vlera: 2.5 Milion Euro për projektin fillestar 7 Milion Euro për projektin e tanishëm	SIML i përfunduar nuk është funksionalizuar kurrë i tëri.	Është përfunduar programi kompjuterik mirëpo nuk është funksionalizuar në plotësi dhe me ndërrimin e teknologjisë është paraqitur nevoja për zhvillim të një programi tjetër. Për programin e ri: Kontraktimi i kompanisë është bërë.	Funksionalizimi i plotë i SIML.
	Data	2002-2003		2020
	Koment		SIML është zhvilluar më parë mirëpo për shkak të mungesës së përdorimit nga ana e gjykatësve ky projekt nuk është zbatuar në praktikë, kjo ka ndodhur para vitit 2010 kur edhe është bërë reforma kadrovike.	
Praktikat më të mira të buxhetimit janë në vend dhe zbatohen	Vlera	Para themelimit të KPK-së, në vitin 2011, MD është kujdesur për buxhetin. Pas 2011, buxheti ka kaluar tek Sekretariati i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit-KPK-së.	Është themeluar Komisioni për Buxhet në KPK. Është siguruar paga për nga një ekonomist në secilën Prokurori nga 1 janari 2014.	Decentralizimi i planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në sistemin prokurorial.
	Data	2011	Nëntor 2013	2015

	Koment			
Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë amandamentuar/hartuar dhe janë në fuqi	Vlera	Kodi i vjetër Penal dhe Kodi i vjetër i Procedurës Penale.	Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale është i ndryshuar dhe është në fuqi.	Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë hartuar dhe janë në fuqi.
	Data	2008	Nëntor 2013	Janar 2013
	Koment	Në vitin 2003 është miratuar ndërsa në vitin 2004 ka hyrë në fuqi Kodi Penal.		
Vlerësimi i Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale	Vlera	Nuk ka vlerësim	Janë përpiluar Termat e referencës për mekanizmin e përbashkët për vlerësimin e funksionimit të ristrukturuar të drejtësisë penale (KGJK, MD, dhe KPK) Është përfunduar faza e parë e punës së Mekanizmit të Përbashkët që ka dalur nga këto Terma të referencës.	Publikimi i Raportit përfundimtar për vlerësimin e sistemit të drejtësisë penale dhe civile
	Data	2010	Nëntor 2013	Janar 2014
	Koment			
Amandamenti/bërja e ligjeve për Këshillin Prokurorial dhe Prokurorin e Shtetit	Vlera	Kanë qenë në fuqi ligjet e vjetra, ai i vitit 1978, rregullore 1981, 1999, UNMIK 2000.	Ligjet e reja janë miratuar dhe janë në fuqi.	Ligji për Prokurorin e Shtetit dhe Ligji për Këshillin Prokurorial janë në fuqi.
	Data			
	Koment	2008	Nëntor 2013	Janar 2011 dhe Janar 2013.

Vlerësimi i ligjeve për Këshillin Prokurorial dhe Prokurorin e Shtetit	Vlera	Nuk ka vlerësim.	Janë përpiluar Termat e referencës për mekanizmin e përbashkët për vlerësimin e funksionimit të ristrukturuar të drejtësisë penale (KGJK, MD, dhe KPK) Është përfunduar faza e parë e punës së Mekanizmit të Përbashkët që ka dalur nga këto Terma të referencës.	Publikimi i Raportit përfundimtar për vlerësimin e sistemit të drejtësisë penale.
	Data			Korrik 2014
	Koment			
???% zvogëlim të kallëzimeve penale të pazgjidhura	Vlera		18,749 kallëzime penale të pazgjidhura.	Nuk ka ndonjë qëllim
	Data		Nëntor 2013	Nuk ka afat të caktuar.
	Koment		Kjo shifër është e mars 2013 nëpër Prokuroritë Themelore	
???% e rritjes së besimit të qytetarëve	Vlera	Nuk ka vlerësim	Nuk ka vlerësim	Vlerësim i kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e prokurorive.
	Data		Nëntor 2013	Nuk ka afat të caktuar.
	Koment			
Themelimi i Mekanizmave jashtë-gjyqësorë (Ndërmjetësimi)	Vlera	Nuk ka pasur	Është themeluar (99 ndërmjetësues të licencuar)	Themelimi i institutit të ndërmjetësimit dhe licencimi i ndërmjetësuesve.
	Data		Nëntor 2013	

	Koment			
Funksionalizimi i Mekanizmave jashtë-gjyqësorë (Ndërmjetësimi) (sa e kanë liru prokurorinë nga rastet)	Vlera	Nuk ka pasur	Gjatë vitit 2012 raste të referuara nga gjykatat, prokuroritë dhe me vet referim janë 178 raste për ndërmjetësim. Prej tyre janë zgjidhur 76 raste, të pazgjidhura janë 63, ndërsa në proces janë 39. Gjatë vitit 2013, në periudhën janar - nëntor, raste të referuara nga gjykatat, prokuroritë dhe me vet referim janë 432 raste për ndërmjetësim. Prej tyre janë zgjidhur 216 raste, të pazgjidhura janë 45, ndërsa në proces janë 52 raste.	Nuk ka ndonjë qëllim.
	Data		Nëntor 2013	Nuk ka afat të caktuar.
	Koment			
Plotësimi i pozitave të prokurorëve	Vlera	89 pozita janë hapur.	124 prokurorë.	171 pozita të plotësuara.
	Data	2009	Nëntor 2013	2014
	Koment			

VIII. REKOMANDIME

Në mënyrë që të adresohen çështjet e reformave të ndryshme në sistemin e drejtësisë, në vazhdim nxjerrim këto rekomandime:

- **Vlerësimet e ndara** - duhet të ndërmerren tri studime të thella dhe të ndara të cilat duhet të rezultojnë me rekomandime konkrete të bazuara në analiza të thuktë se si duhet të reformohet 1) Drejtësia Penale, 2) Civile, dhe 3) Administrative.
- **Vlerësimet e specializuara** – patjetër duhet të bëhen vlerësime dhe analiza të thella sa i përket themelimit të gjykatave/dhomave të veçanta sikurse ajo për Krime të Rënda dhe çështje Administrative. Me strukturën e tanishme duket se çështja e krimeve të rënda dhe drejtësia administrative nuk është adresuar më së miri, me fokus në kualitetin e kuadrove dhe stimulimin.
- **Përpilimi i strategjisë gjithëpërfshirëse** - duhet të bëjmë një strategji se si do të vazhdohet më tutje me reformën, ashtu që të përcaktohen qëllimet që synohet të arrihen dhe iniciativat që do të ndërmerren. Një strategji e tillë do të ndihmonte edhe në vlerësimet e mëvonshme të ligjeve dhe politikave të caktuara. Gjithashtu, strategjia do të të ndihmonte bashkërendimin e aktiviteteve në mes të akterëve të ndryshëm.
- **Ndarje e resurseve adekuate** – duhet të ndahen resurse adekuate për të mundësuar zbatimin e plotë të ligjeve, sidomos atyre bazike për sistemin gjyqësor dhe prokurorial.
- **Llogaridhënia** – Pasi që pavarësia e sistemeve gjyqësor dhe prokurorial është siguruar në masë të lartë, tani fokusi duhet të vendoset në forcim të llogaridhënies. Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të analizojnë dhe gjejnë një model më të avancuar dhe më efikas të llogaridhënies së sistemit gjyqësor dhe prokurorial.
- **Reforma e administratës** - Duhet të gjendet një model i filtrimit të stafit mbështetës në administratën gjyqësore dhe duhet të krijohet një mekanizëm më efikas për kontrollin e performancës së tyre, pasi mbetet sfida e madhe për institucionet e drejtësisë.